



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 2 Shkurt 2021 | Nr: 2

**UDHËZIM**

**PËR PROCEDURAT E AKREDITIMIT DHE RREGULLAT E VËZHIMIT TË  
ZGJEDHJEVE NGA ORGANIZATAT JOQEVERTARE SHQIPTARE DHE TË HUAJA,  
ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE, PËRFAQËSUES TË SHTETEVE TË HUAJA,  
MEDIAVE DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**U D H Ë Z O J:**

**KREU I**  
**QËLLIMI DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky udhëzim përcakton rregullat për akreditimin, të drejtat, detyrat, kriteret dhe standartet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga subjektet zgjedhore, organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe mediave.

**Neni 2**  
**Kushtet për të qenë vëzhgues**

1. Vëzhguesi duhet të plotësojë kushtet për të qenë zgjedhës dhe të jetë i padënuar penalisht.
2. Vëzhguesi duhet të propozohet nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 6 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (më poshtë Kodi Zgjedhor).



### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja e mandatit të vëzhguesve**

1. Vëzhguesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me afatet e përcaktuara në autorizimin e lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)/KZAZ.
2. Vëzhgues afatgjatë konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja/KZAZ-ja për të vëzhguar procesin nga momenti i akreditimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
3. Vëzhgues afatshkurtër konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja/KZAZ-ja për të vëzhguar procesin shtatëdhjetë e dy (72) orë para datës së zgjedhjeve deri në përfundimin e numërimit të votave.

## **KREU II**

### **PROCEDURA PËR ÇAKTIMIN E VËZHguesVE**

#### **Neni 4**

#### **Kërkesa e OJF-ve shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare, përfaqësuesve të shteteve të huaja dhe mediave për akreditimin e vëzhguesve**

1. OJF-ve shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe mediave, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të paraqesin pranë KQZ-së dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kërkesë nga drejtuesi apo përfaqësuesi i subjektit që kërkon të vëzhgojë procesin zgjedhor. Kërkesa duhet të përmbajë adresën, numrin e telefonit dhe informacione të tjera për kontaktim.
  - b) Vërtetimin e regjistrimit në gjykatë ose në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe/ose ftesën përkatëse.
  - c) Lista të veçanta për:
    - i. Vëzhguesit afatgjatë (Model nr. 01-LV)
    - ii. Vëzhguesit afatshkurtër (Model nr. 02-LV)
    - iii. Përkthyesit e propozuar (Model nr. 03-LP)
    - iv. Përfaqësuesit e medias të propozuar (Model nr. 04-LM)
2. Kërkesa për akreditim dhe listat e vëzhguesve sipas shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni, paraqiten me shkrim. Kopje të listave në formë elektronike, në programin EXCEL sipas modeleve nr. 01-LV, 02-LV, 03-LP dhe 04-LM, bashkëlidhur këtij udhëzimi, duhet të paraqiten së bashku me kërkesën e subjektit.
3. Dokumentet e listuara më sipër duhet të dorëzohen në KQZ.
4. Nëse dokumentacioni plotëson të gjitha kërkesat, KQZ vazhdon me përgatitjen e autorizimeve të vëzhguesve.
5. Në rast të evidentimit të mungesave në dokumentacionin e paraqitur, KQZ njofton kërkuesin se nuk është akredituar për të vëzhguar zgjedhjet.



## **Neni 5**

### **Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore**

1. Subjekti zgjedhor, ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave, pas regjistrimit të kandidatit/kandidatëve për zonën zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumemërore, sipas rregullave që përcaktohen në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
2. Në rast se partitë politike paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni. Koalicioni mund të caktojë jo më shumë se tre përfaqësues për koalicion.
3. Kandidatët e partive politike nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.

## **Neni 6**

### **Akreditimi i vëzhguesve të subjekteve zgjedhore**

1. KQZ u delegon KZAZ-ve, kompetencën për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore sipas përcaktimit në pikën 6 të nenit 6, të Kodit Zgjedhor.
2. KZAZ-ja bën akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi.
3. Akreditimi mund të përfshijë një ose më shumë qendra votimi brenda Zonës së Administrimit Zgjedhor (ZAZ-së).
4. Çdo parti politike, apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor mund të kërkojë akreditimin vetëm të një vëzhguesi në KZAZ, KQV dhe për çdo tavolinë në VNV pas regjistrimit të kandidatit/ kandidatëve për zonën zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumemërore.
5. Në rast se partitë politike paraqiten në zgjedhjet si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni. Koalicioni zgjedhor mund të kërkojë akreditimin e jo më shumë se tre (3) vëzhguesve për koalicion.
6. Vëzhguesi/vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, të akredituar në KZAZ, mund të vëzhgojnë procesin zgjedhor dhe në qendrat e votimit të kësaj ZAZ-je. Vëzhguesi i KZAZ-së mund të jetë vëzhgues dhe në VNV.
7. KQV në asnjë rast, nuk mund të lejojë që në mjedisin e Qendrës së Votimit të jenë të pranishëm më shumë se një (1) vëzhgues i një partie politike, një (1) vëzhgues i kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, tre (3) vëzhgues të një koalicioni.

## **Neni 7**

### **Kërkesa për vëzhgues të subjekteve zgjedhore**



1. Kërkesa e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve në KZAZ, KQV dhe VNV, i paraqitet KZAZ-së përkatëse.
2. Kërkesa duhet të ketë bashkëngjitur:
  - a) listën e vëzhguesve që kërkohet të akreditohen pranë KZAZ/KQV/VNV të nënshkruar në çdo faqe nga kryetari i partisë/përfaqësuesi i koalicionit/kandidati i propozuar nga zgjedhësit, ose personi i autorizuar prej tyre, sipas modelit të përcaktuar në lidhjet nr. 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
  - b) vërtetimin që partia/koalicioni/kandidati i propozuar nga zgjedhësit është i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor dhe për partinë politike/koalicionin, që ka depozituar listat shumëemërore.
  - c) Vetdeklarimin e vëzhguesit për gjendjen gjyqësore.
3. Kërkesa për akreditimin e vëzhguesve dhe dokumentacioni përkatës mund të paraqiten nga personat e autorizuar, nga kryetari i partisë/përfaqësuesi i koalicionit/kandidati i propozuar nga zgjedhësit. Akti i autorizimit depozitohet në KZAZ.

## **Neni 8**

### **Përgjegjësitë e subjekteve vëzhguese**

1. Subjektet që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, janë përgjegjës për saktësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe të të dhënave personale të paraqitura për secilin prej vëzhguesve të propozuar.
2. Subjektet vëzhguese kanë detyrim t'i bëjnë të ditur përmbajtjen e këtij udhëzimi të gjithë vëzhguesve të tyre.

## **Neni 9**

### **Afatet e kërkesave për akreditim**

1. Subjektet shqiptare, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të paraqesin kërkesat dhe dokumentacionin përkatës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Subjektet e huaja duhet të paraqesin kërkesat dhe dokumentacionin përkatës ,jo më vonë se shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara datës së zgjedhjeve.
3. Kërkesat e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve i paraqiten KZAZ-së jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së zgjedhjeve.
4. KZAZ, miraton kërkesat e subjekteve zgjedhore për akreditim të vëzhguesve jo më vonë se pesë (5) ditë nga paraqitja e tyre.
5. Në rast të evidentimit të mungesave në dokumentacionin e paraqitur, në përmbajtje ose në formë, KZAZ vendos kthimin, me qëllim plotësimin e tij, subjektit zgjedhor përkatës.
6. Dokumentacioni i plotësuar ridepozitohet pranë KZAZ-së brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit të kthimit. Verifikimi i dytë i dokumentacionit të riparaqitur pas plotësimit kryhet nga KZAZ-ja brenda 24 orëve nga ridepozitimi i tij.

## **Neni 10**

### **E drejta e ankimit**



1. Kundër vendimit të KQZ-së për mosdhënien ose refuzimin e akreditimit të vëzhguesve mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) brenda tre (3) ditëve nga shpallja e vendimit të refuzimit të kërkesës
2. Kundër vendimit të KZAZ-së për refuzimin e kërkesës për akreditim të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) brenda tre (3) ditëve nga shpallja e vendimit të refuzimit të kërkesës.

## **KREU III IDENTIFIKIMI I VËZHguesVE**

### **Neni 11**

#### **Autorizimi dhe mandati vëzhguesve**

1. KQZ-ja pajis çdo vëzhgues me autorizim përkatës sipas modelit nr. 05- AV, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Vëzhguesit e miratuar me vendim nga KZAZ-ja përkatëse, regjistrohen nga Sekretari i KZAZ-së në Librin e Protokollit të KZAZ-së dhe pajisen nga ai me autorizimin përkatës, sipas modelit të përcaktuar në Lidhjen nr. 06- AV, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
3. Autorizimi është i vlefshëm për njësi zgjedhore, qendra votimi apo vend numërimi të votave dhe i jep vëzhguesit të drejtën të hyjë dhe të qëndrojë në ambientet e tyre duke respektuar të drejtat dhe detyrat që u njeh Kodi Zgjedhor, ky udhëzim, si dhe akte të tjera nënligjore të KQZ-së.
4. Vëzhguesit mund të kryejnë vëzhgime vetëm në ambientet zgjedhore të përcaktuar në autorizimin e KZAZ-së.
5. Në autorizimin e lëshuar duhet të përcaktohet:
  - a) emri, mbiemri i vëzhguesit;
  - b) emri i subjektit zgjedhor që e cakton si vëzhgues dhe
  - c) qendra e votimit/Vendi i Numërimit të Votave/KZAZ në autorizimin e lëshuar nga KZAZ-ja.
6. Autorizimi tregon edhe afatin e vlefshmërisë. Autorizimi mban vulën e KQZ/KZAZ-së dhe është i firmosur nga titullari i institucionit, kryetari dhe zv.Kryetari i KZAZ-së, dhe i vulosur me vulën e KZAZ-së.

### **Neni 12**

#### **Prezantimi i vëzhguesve**

1. Vëzhguesit kanë të drejtë të qëndrojnë në Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor, Qendrën e Votimit dhe Vendet e Numërimit të Votave (KZAZ, QV, VNV).
2. Ata duhet të paraqiten para Komisioneve Zgjedhore me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja si dhe me një dokument identifikimi personal.
3. Sipas rastit, KZAZ-ja ose KQV-ja shënon në procesverbal emrin e vëzhguesit, subjektin vëzhgues që ai përfaqëson, numrin e autorizimit dhe numrin e dokumentit të identifikimit.



4. Në një qendër votimi, nuk mund të ketë në të njëjtën kohë, më shumë se dy vëzhgues nga i njëjti subjekt vëzhgues i huaj dhe jo më shumë se një vëzhgues nga i njëjti subjekt vëzhgues vendas.
5. Në VNV nuk mund të ketë më shumë vëzhgues nga një subjekt se sa janë tavolinat e numërimit. Për një tavolinë numërimi nuk mund të ketë më shumë se një vëzhgues nga i njëjti subjekt.
6. Vëzhguesit e huaj mund të shoqërohen nga një përkthyes brenda ambienteve zgjedhore. Përkthyesi është i pajsur me autorizimin përkatës lëshuar nga KQZ-ja sipas modelit nr. 05- AP, bashkëlidhur me këtë udhëzim dhe me një dokument identifikimi personal. Përkthyesi nuk mund të hyjë i vetëm në KZAZ, KQV apo në VNV.

## **KREU IV TË DREJTAT DHE DETYRAT E VËZHguesVE**

### **Neni 13 Të drejtat e vëzhguesve**

Vëzhguesit, përveç atyre të parashikuara në nenin 7, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kanë këto të drejta:

- a) T’i drejtojnë pyetje Komisionit Zgjedhor, pa penguar në veprimtarinë e tij;
- b) Të hyjnë dhe të dalin pa pengesa në ambientet zgjedhore.

### **Neni 14 Detyrat e vëzhguesve**

Vëzhguesit, krahas atyre të parashikuara në nenin 7, paragrafi 2, të Kodit Zgjedhor, kanë edhe këto detyra:

- a) Të mos ndërhyjnë në procesin zgjedhor, në procedurat e ditës së votimit, në procesin e numërimit të votave, në procesin e nxjerrjes së rezultatit dhe aktivitetin e Komisioneve Zgjedhore;
- b) Të respektojnë rregullat e etikës në ambientet zgjedhore;
- c) Të mos komentojnë dhe/ose debatojnë vendimet e KQV/KZAZ/GNV dhe procesin e votimit.
- d) Të mos marrin ose japin intervista, të mos kryejnë sondazhe me votuesit brenda qendrës së votimit dhe jashtë saj deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) metra distancë nga qendrat e votimit.

## **KREU V DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 15**



## Shfuqizime

Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave" dhe Udhëzimi nr.10, date 14.04.2009 "Për procedurat dhe kriteret e akreditimit nga KZAZ-ja të vëshguesve të subjekteve zgjedhore në KZAZ, KQV dhe VNV, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", shfuqizohen.

### Neni 16 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
**Ilirjan CELIBASHI**

**Kopje:** 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet  
Konceptoi Dh.Kërçani \_\_\_\_\_  
Miratoi/E.Allushi \_\_\_\_\_  
Konfirmoi/Y.Merkaj \_\_\_\_\_

**Nr. Prot** \_\_\_\_\_  
**Datë** \_\_\_\_\_



Data: 2 Shkurt 2021  
Udhëzim : Nr. 2

"Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave dhe subjektet zgjedhore"

Lista Vëzhguesve Afatgjatë për akreditim bashkëlidhur me kërkesë  
Nr. Prot \_\_\_\_\_ datë /\_\_\_/ 2021 të \_\_\_\_\_

NR.	EMËR	MBIEMËR	ORGANIZATA	MANDATI	SHTETËSIA	DT. LINDJE (dd.mm.vvvv)	NR. DOKUMENT IDENTIFIKIMI	ZONA E VEZHGIMIT	VLEFSHMËRIA	GJINIA
				AFATGJATË						



**Lidhja 2**

Model nr. 02- LV

Lista e Vëzhguesve Afatshkurtër për akreditimin bashkëlidhur me kërkesë  
Nr. Prot \_\_\_\_\_ datë /\_\_\_/ 2021 të \_\_\_\_\_

NR.	EMËR	MBIEMËR	ORGANIZATA	MANDATI	SHTETËSIA	DT. LINDJE (dd.mm.vvvv)	NR. DOKUMENT IDENTIFIKIMI	ZONA E VEZHGIMIT	VLEFSHMËRIA	GJINIA
				AFATSHKURTËR						



Data: 2 Shkurt 2021

Udhëzim : Nr. 2


"Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndëkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave dhe subjektet zgjedhore"

Lista e përkthyesve për akreditim bashkëlidhur me kërkesë  
Nr. Prot \_\_\_\_\_ datë / \_\_\_\_ / 2021 të \_\_\_\_\_

NR.	EMËR	MBIEMËR	ORGANIZATA	MANDATI	SHTETËSIA	DT. LINDJE (dd.mm.vvvv)	NR. DOKUMENT IDENTIFIKIMI	ZONA E VEZHGIMIT	VLEFSHMËRIA	GJINIA
				PËRKTHYES						

Lista e përfaqësuesve të Medias për akreditim bashkëlidhur me kërkesë  
Nr. Prot \_\_\_\_\_ datë / \_\_\_\_ / 2021 të \_\_\_\_\_

NR.	EMËR	MBIEMËR	ORGANIZATA	MANDATI	SHTETËSIA	DT. LINDJE (dd.mm.vvvv)	NR. DOKUMENT IDENTIFIKIMI	ZONA E VEZHGIMIT	VLEFSHMËRIA	GJINIA



Data:Shkurt 2021

Nr.

"Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndëkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave dhe subjektet zgjedhore"



## Vëzhgues Observer

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë , 25 Prill 2021 /  
April 25, 2021 Elections to the Albanian Assembly



## Vëzhgues Observer

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë , 25 Prill 2021 /  
April 25, 2021 Elections to the Albanian Assembly



## Vëzhgues Observer

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë , 25 Prill 2021 /  
April 25, 2021 Elections to the Albanian Assembly



## Vëzhgues Observer

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë , 25 Prill 2021 /  
April 25, 2021 Elections to the Albanian Assembly



Data:Shkurt 2021

Nr.

"Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndëkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave dhe subjektet zgjedhore"

 **REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE 

QARKU \_\_\_\_\_  
KZAZ NR \_\_\_\_\_

# Vëzhgues i subjektit zgjedhor

Emri: \_\_\_\_\_

Mbiemri: \_\_\_\_\_

Subjekti zgjedhor: \_\_\_\_\_

Vëzhgues në:  KZAZ  KQV  VNV

**Kryetar**  **Zv.Kryetar**

Emër Mbiemër \_\_\_\_\_ Emër Mbiemër \_\_\_\_\_



# Vëzhgues i subjektit zgjedhor

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 25 Prill 2021